



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	26.10.2021
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	VETËVENDOSJE
Përmes/Preko/Through:	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike. Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim



Drejtorija për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën përmes emailit zyrtar nga VETËVENDOS-ja përmes të cilës kërkohet të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike dhe vendosjen e tendave në këto lokacione:

- Sheshi “ Nëna Terezë” përball Ministrisë së Kulturës;
- Bulevardi “Bill Clinton” përball shtatorës;
- Rruga “Xhorxh Bush” përball katedrales;
- Rruga “B”;
- Bregu i Diellit;
- Kodra e Trimave;
- Rruga “Bajram Bahtiri”

Shfrytëzimi i hapësirës kërkohet nga data 27.10.2021 deri më 07.11.2021.

Drejtorija pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin VETËVENDOSJE-s së për shfrytëzimin e hapësirës publike në lokacione e kërkuara nga data 27.10.2021 deri më 07.11.2021 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Për të njëjtin aktivitet të lajmërohet Policia e Kosovës;
- Aktiviteti duhet të jetë në koordinim dhe me pëlqim nga KKZ-ja;
- Mos të pengohet lëvizja e lirë e qytetarëve;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi;
- Pas përfundimit të aktivitetit hapësira publike duhet të lirohet dhe të kthehet në gjendjen e mëparëshme.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar